


DUART QË NDIHMOJNË JANË MË TË MIRA



SESA ATO QË LUTEN

PARIMET E DEMOKRACISË

DIAR (11), BLENDI (11), GENT (10), SAMIRA (11), AURELA (10), ERËZA (10)




A e keni menduar ndonjëherë sesi do të ishte jeta jonë po të mos jetonim në një shtet demokratik?

Ne nuk duam as të mendojmë se si do të ishte jeta pa demokraci, sepse nuk do të na pëlqente aspak.

Prandaj, jemi shumë të lumtur dhe të gëzuar që jetojmë në një shtet me sistem demokratik, siç është Kosova. Në demokraci secili qytetar ka vlerë. Kjo i bie se të gjithë trajtoheni të barabartë, shprehemi lirshëm, tregohemi tolerant ndaj njëri-tjetrit dhe i respektojmë të tjerët.

Pra, demokracia të jep liri, mundësi, po ashtu edhe përgjegjësi. Demokracia të jep përgjegjësi, sepse duhet të kujdesesh për të, në mënyrë që të zhvillohet dhe të rritet niveli i saj. Ajo për ndryshe i bie qeverisje e popullit. Kjo nënkupton se populli e ka fuqinë më të madhe për të vendosur për të ardhmen. Këtë e bën me anë të procesit të votimit, ku përmes tij zgjedhen përfaqësuesit e popullit, të cilët janë deputetët. Për këtë arsye, Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare.

Ne, të dashur lexues, shpresojmë se keni mësuar diçka nga ky artikull. Por nuk do ta përmbylim me kaq, sepse do t'iu tregojmë edhe mesazhin e fundit që kemi për ju. Kontributi juaj për të mirë, ndikon në zhvillimin dhe ngritjen e nivelit të demokracisë. Nëse së bashku fillojmë të jemi aktiv, ne do të arrijmë të kemi zhvillim shtetëror. Ky zhvillim, do ta përmirësojë jetën e të gjithë qytetarëve, e ky është pikërisht synimi kryesor i



Jeta jonë lulëzon kur e kemi nivelin e lartë të demokracisë, prandaj kontribuoni sa më shumë për këtë nivel

demokracisë.

Mos harroni, e ardhmja është në duart tuaja. Bëhuni sa më të përgjegjshëm për veprimet që i bëni, sepse këto veprime e ndikojnë edhe jetën tonë. Ndrehuni krenarë për vendin tuaj dhe mendoni gjithmonë se si t'i ndihmoni të tjerët.



Ne mendojmë dhe veprojmë për demokracinë

ZGJEDHJET NË DEMOKRACI

EDUARD (11), LEARTA (10), ORGES (10), ËNGJULL (11), ZANA (11), DORESA (11)

Ne nxënësit e klasës së V-të, sot kemi mësuar për rëndësinë e zgjedhjeve në demokraci. Nëse dëshironi edhe ju të mësoni për zgjedhjet, lexojeni artikullin më poshtë

Learta është një vajzë 10 vjeçare, e cila kur zgjohet në mëngjes, zgjedh rrobat që dëshiron t'i vesh. Po ashtu, asaj i pëlqen shumë që të lexoj libra, dhe gjatë kohës së lirë ajo zgjedh librin që preferon ta lexojë. Pra, zgjedhje do të thotë të marrësh vendim për diçka. Mirëpo, Learta për të marrë pjesë në procesin zgjedhor duhet t'i mbushë 18 vjet, sepse atëherë ajo ka të drejtën e votës në procesin zgjedhor.

Zgjedhjet në demokraci janë proces shumë i rëndësishëm. Çdo njeri, ka të drejtën e votës. Janë dy lloje të zgjedhjeve në demokraci, dhe ato janë: zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet qendrore.

Në zgjedhjet komunale, qytetarët votojnë kandidatët për kryetar të komunës. Kurse, në zgjedhjet qendrore, populli voton kandidatët për deputetë, të cilët përfaqësojnë popullin. Këta përfaqësues zgjedhen me vota të fshehta, për të mos pasur manipulime.

Në demokraci të gjithë kanë të drejta të barabarta, por ka edhe ligje ose rregulla që duhet të respektohen. Po ashtu, ne kemi të drejtat tona edhe pse jemi fëmijë të vegjël, p.sh.: të drejtën e kujdesit shëndetësor, të drejtën e lojës, të drejtën e familjes, të drejtën e strehimit, të drejtën e shkollimit, të drejtën e zgjedhjes së librit që na pëlqen, etj.

Pra, në demokraci të gjithë qytetarët kanë vlerë, pa varësisht moshës dhe gjinisë.



Ne jemi e ardhmja e vendit



Zgjedhja është e jona




E drejta e votës



Jemi të lirë të zgjedhim



Këtu kemi vizatur një shoqe dhe një shok në bankat shkollore. Sipas nesh, nuk ka gjë më të shenjtë në jetën tonë dhe më të çmuar se e drejta e edukimit. E vendi ynë, Kosova ua mundëson të gjithë qytetarëve të kenë edukim të mirëfilltë, pa dallim gjinie, race apo feje



Informatat dhe dijen që sot ne morëm në këtë Punëtori na bëjnë të rrezatojmë si dielli



Të gjitha këto njohuri që sot i mësuam, do t'i bartim tek shokët e tjerë



Libri është çelësi drejt suksesit. Ne duam të jemi të suksesshëm, për këtë libri është pjesë e pandashme e jona



Të gjitha këto që i thamë më lart, pa dyshim i garanton demokracia. Demokracia, gëzimi ynë

KUVENDI ËSHTË SHTËPIA JONË

ORIKË (11), ALORA (12), OLSA (11), ANDI (11), ERDRIN (11), TRIUMF (12), EDION (10)




Kuvendi nuk është vetëm shtëpia jonë, Kuvendi është shtëpia e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës

Të dashur lexues, artikulli që kemi përgatitur për ju, ka të bëjë me Kuvendin dhe do t'iu informojë më shumë për rëndësinë e tij. Kuvendi ndryshe quhet „Shtëpia e Popullit“, sepse populli është ai i cili i zgjedh përfaqësuesit e vet që ne i njohim si deputetë. Deputetët, pra, janë zëri i popullit, të cilët marrin vendime për të mirën e të gjithë qytetarëve. Ne do t'iu tregojmë disa vendime apo thënë më mirë ligje, të cilat janë në të mirën tonë si nxënës së pari, pastaj si shoqëri. Kur themi si nxënës, e kemi parasysh ligjin të cilitin e ka miratur Kuvendi, që secili fëmijë në vendin tonë të gëzojë të drejtën për t'u arsimuar. Por, ne më shumë i gëzohemi faktit që asnjë fëmijë në Kosovë nuk mbetet i paarsimuar. Ashtu siç e dijmë, edukimi është një ndër elementet kryesore për zhvillimin e një shteti. E këtë të mirë për ne e ka siguruar Kuvendi.

Ky institucion, ka shumë detyra dhe përgjegjësi, por për tri funksionet kryesore të Kuvendit ne do të flasim më poshtë. Fillojmë me funksionin legjislativ, i cili shpjegon detyrën e deputetëve në propozimin dhe miratimin e ligjeve. Po ashtu, këto ligje që miratohen duhet zbatuar dhe për këtë merret Qeveria, e ky është funksioni tjetër i Kuvendit, funksioni kontrollues. Kjo do të thotë se Kuvendi e kontrollon punën e Qeverisë. Si dhe funksioni përfaqësues, sepse deputetët përfaqësojnë popullin, i cili ua ka besuar votën. Popullin tonë e përfaqësojnë 120 deputetë. 100 prej tyre janë të kombësisë shqiptare, kurse 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë. Një ndër arsye pse janë kaq shumë deputetë është se ne jemi afër 2 milionë banorë, dhe si të tillë kemi nevoja dhe kërkesa të ndryshme. E deputetët janë ata të cilët i plotësojnë këto nevoja dhe kërkesa tona.

Dera e Kuvendit është e hapur për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ashtu siç ishte për ne sot.



Librat janë shkallët për të arritur të ardhme të ndritur



Autorët e së ardhmes



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Thimi Mitko“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan